



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 6 Korrik 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10
Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Gani Geci, Agim Veliu, Bojan Stojanovič, Melihate Termkollli, Ibrahim Selmanaj dhe Zylfi Merxha.

Mungoi: Zafir Berisha

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Blerina Pula dhe Nuredin Ibishi

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **17.06.2009**
3. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga komisioni
4. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje

2. Miratimi i procesverbalit të datës 17.06.2009

Procesverbali i datës 17.06.2009 u miratua pa vërejtje.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga komisioni

Kryetari i Komisionit – tha, ne e dimë që në kompetencën tonë është procesi i zbatimit të ligjeve. Ne si komision rastin e fundit në polici e kemi trajtuar shumë herë dhe pati diskutim edhe në seancë. Unë propozoj që të marrim një nismë për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit për Policinë e Kosovës, për të parë se ku janë arsyet e mos zbatimit të tij. Unë si kryetar do të dal me një propozim për formimin e një grupi të punës. Propozoj që ky grup të përbëhet nga: Agim Veliu, Emrush Xhemajli, Gani Geci dhe Ibrahim Selmanaj.

Shkumbin Demaliaj – Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është detyrë e komisionit. Ligji për policinë nuk është duke u zbatuar si duhet duke u nisur nga pagat e policëve. Ka shkelje të mëdha ligjore, dhe mendoj se është e domosdoshme të formohet ky komision, dhe të dalim me rekomandime lidhur me punën që e bën komisioni.

Gani Geci – Ne e dimë se ligji për policinë nuk po zbatohet dhe e kemi pasur edhe rastin ku ligji për Inspektoratin nuk është zbatuar. Nëse ne e formojmë këtë komision dhe i dërgojmë rekomandimet tona atëherë ne kërkojmë që rekomandimet të shkojnë për votim.

Agim Veliu –Unë pajtohem me formimin e një komisioni të tillë për monitorimin e zbatimit të ligjeve si përgjegjësi e komisionit. Ne si komision duhet të merremi vesh se me çka të përfundojmë. A duhet të përfundojmë me një raport për kuvendin, informatë për komisionin apo me raport me rekomandime për kuvend.

Melihate Termkollli – Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit është një detyrë permanente e komisionit. Unë mendoj se nuk do të ketë ndonjë ndryshim të gjendjes në kuptim të zbatimit të ligjit, dhe përmbushjes së detyrës së parlamentit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Eqrem Kryeziu - Kryesia ka marrë vendim në bazë të rekomandimeve të ofruara nga ky komision për thirrjen në seancë të Ministrit Zenun Pajaziti.

Bojan Stojanovič – Komisioni duhet të funksionon, dhe ne duhet të vazhdojmë të punojmë edhe pse nuk jemi të kënaqur me mbështetjen që na ofron Kuvendi. Komisioni duhet të vazhdojë punën e tij edhe pse kryesia nuk i merr parasysh rekomandimet tona. Sa i përket mbikëqyrjes së ligjit, këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me ligjin për policinë por edhe me ligje tjera. Si p.sh. për letërnjoftimet në Prizren pse nuk përdoret gjuha turke?

Eqrem Kryeziu – Unë mendoj se emri shkruhet në origjinal në letërnjoftim. Mua më intereson çështja e dokumenteve a është komunale apo e shtetit të Kosovës.

Kryetari i Komisionit – tha, a jeni të pajtimit që emrat e përmendur të jenë pjesë e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit ?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e Kryetarit për përbërjen e grupit punues.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – tha, në këtë pikë desha të përmend ngjarjen që ka ndodhur me datë 26 Qershor 2009 në fshatrat Novoselë dhe Karaçevë të komunës së Kamenicës. Ne kemi kërkuar një raport nga Ministria e Punëve të Brendshme. Raporti i sjellë përfshin në detaje të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë për ruajtjen e rendit dhe qetësisë.

Desha t’iu njoftoj për obligimet që i ka komisioni për raportin e progresit të Komisionit Evropian. Raporti i sjellë nga Ministria e Punëve të Brendshme, përmbyll obligimet e komisionit në lidhje me këtë raport të progresit.

Desha t’iu njoftoj se unë do ta kem një proces gjyqësore, dhe për këtë arsye e caktoj z. Shkumbin Demaliaj që të më zëvendësojë. Pra, z. Demalilaj, është zv-kryetar i komisionit, dhe do të drejtojë komisionin në këtë kohë.

Bojan Stojanovič – Si shqetësim i imi dhe i komunitetit tim ka qenë lëshimi i vendeve te punës nga policët serb duke i shkaktuar shumë dëme buxhetit të Kosovës. Unë mendoj se tani duhet të gjendet ndonjë model se çka të bëhet më tutje me këtë çështje. Unë kam propozuar që një kohë të gjatë t’iu ndërprehen pagat sepse ata do të kthehen në punë dhe ashtu ndodhi, të gjithë janë kthyer. Do të krijohet struktura në Policinë e Kosovës, dhe atëherë do të shihet kush punon e kush jo. Policët e kanë lëshuar punën afër 16 muaj, e tani kur kthehen i kanë nga 56 apo 57 vite dhe nuk dihet se si të veprohet me ta. E them këtë për arsye se ka më shumë se 500 të rinj që presin dhe janë të gatshëm të punojnë.

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit
Rrustem Mustafa